



Nr. 5407/1 Prot
Dt. 20.10.22

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.685/1prot.

Shkodër, më 20.10.2022

LËNDA: Mbi vendimin Nr.64, datë 10.10.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau-Dejës.

KËSHILLI BASHKIAK VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin Nr.107 datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, neni 29, neni 53 pika 3, germa a, neni 54/dh, neni 55/3, neni 64/c, neni 22, pika 3 e ligjit Nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, ligjit Nr.9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor" i ndryshuar, ligjit Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 30, shkronja "gj", neni 41, pika 2, VKM Nr.414, datë 8.07.2022 "Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për mbrojtjen civile", pika 3.1 shkronja a, VKM Nr.329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", kap.III, pika 3, germa ç, shkresës së AKMC Tiranë Nr.1007/1 prot datë 17.06.2022 "Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022", shkresës së MFE Nr.6937/1prot date 28.04.2022 "Për detajim në programin 10910, me emertim produkti "Shtetas të ndihmuar, banesat e të cilëve janë ndihmuar nga fatkeqësi të ndryshme", VKB Vau-Dejës Nr.23 date.24.04.2020 "Mbi miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit bashkiak Vau-Dejës", neni 61, dokumentacionit shoqërues të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Vau-Dejës Nr.5405 prot, datë 11.10.2022, shqyrtoi **VKB Vau-Dejës nr.64 datë 10.10.2022** "Mbi shpërndarjen e ndihmës financiare familjeve të dëmtuara në shumën totale prej 4.282.581 lekë për 46 familjeve të dëmtuara nga reshjet me intensitet të lartë të datës 10.09.2022 në Bashkinë Vau-Dejës".

Pas trajtimit, Prefekti ju autorizon procedim konform procedurave të mëtejshme ligjore, duke zbatuar kompensimin financiar për secilin përfitues jo më shumë se 50% e vlerës së llogaritur të dëmit (sipas vlerësimit të komisioni i emergjencave civile në bashki), sipas VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, pika 3, shkronja "ç".
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I


Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 64 datë 10.10.2022

Mbi

Dhënien e ndihmës financiare familjeve të dëmtura nga reshjet me intensitet te larte të dt.10.09.2022

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetë qeverisjen vendore” i ndryshuar ,Ligji Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”,Vendimi Nr.414 dt.08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për Mbrojtjen Civile,si dhe në shkresën Nr.1007/1 prot dt.17.06.2022”Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”,të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3567 Prot dt.22.06.2022, si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.5 dt.28.09.2022, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për 46 familje banesat e të cilëve janë dëmtuar nga reshjet e dt.10.09.2022 banorë të Bashkisë Vau-Dejës:

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,


KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I:

1. Miratimin e dhënies së ndihmës financiare prej **4,282,581 (katërmilion e dyqind e tetëdhjetë e dy mije e pesëqind e tetëdhjetë e një)** për **46** (dyzet e gjashtë) familjet e Bashkisë Vau-Dejës të dëmtuar nga reshjet e rëna me intensitet të lartë me dt.10.09.2022 për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesat e tyre sipas tabelës bashkëngjitur:
2. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banoreve të dëmtuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



3. **Burimi i financimit** do të jetë fondi i kushtëzuar i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në rishpërndarjen e fondit për Emergjencat Civile për vitin 2022” që është bërë i disponueshëm në Sistemin Informatik financiar të Qeverisë sipas shkresës Nr.1007/1 prot dt.17.06.2022”Mbi akordimin e fondeve të kushtëzuara për vitin 2022”,të AKMC e protokolluar nga ana jonë me shkresën nr.3567 Prot dt.22.06.2022.
4. Ngarkohen Drejtoria Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e ketij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

KRYETAR

Mark Bisha

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Arshon Çelepu

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 11.10.2022

